

MARRËVESHJE PËR SHKËMBIMIN/KALIMIN E KUOTAVE

Kjo Marrëveshje për Shkëmbimin/Kalimin e Kuotave ("**Marrëveshja**") është bërë dhe nënshkruar nga dhe ndërmjet Palëve të mëposhtme:

- **Investment Joti - Infosoft Group Shpk.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në përputhje me ligjin shqiptar, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) K91425022E, me seli në adresën: *Rruga "Murat Toptani", Gjergji Center, Tiranë*, e përfaqësuar nga përfaqësuesi i saj ligjor Blerta Elezaj, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "Investment Joti – Infosoft Group" Shpk. nr. 12, datë 05.12.2024, bashkëlidhur (në vijim referuar si "**Ortaku IJ**").

Dhe

- **Plarent Kristo**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.05.1968, lindur dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër 033811855 dhe numër personal G80529087K (në vijim referuar si "**Ortaku PK**").

Ortaku IJ dhe Ortaku PK këtej e tutje do t'i referohen individualisht si "Palë" dhe së bashku si "Palët".

DUKE QËNË SE:

- Ortaku IJ zotëron një kuotë që përfaqëson 52% (*pesëdhjetë e dy përqind*) të kapitalit në shoqërinë **Interbrands Shpk.**, (në vijim referuar si "**IB**"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Autostrada Tiranë-Durrës, Km 1, Tiranë, e regjistruar në përputhje me ligjin shqiptar, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) **J81405008F**, me objektin e aktivitetit që përfshin importin, eksportin dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore, produkteve të higjienës personale, kozmetikës, detergjenteve dhe artikujve të tjerë industrialë. Shoqëria gjithashtu kryen aktivitete të tjera ndihmëse në fushën e distribucionit dhe transportit të mallrave.
- Ortaku PK zotëron një kuotë që përfaqëson 24% (*njëzetë e katër përqind*) të kapitalit në shoqërinë **Inter Trade & Distribution Shpk.**, (në vijim referuar si "**IT&D**"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Autostrada Tiranë-Durrës, Km 1, Tiranë, e regjistruar në përputhje me ligjin shqiptar, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) **K91524002L**, me objekt aktiviteti në fushën e importit, eksportit dhe tregimit me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore, produkteve të higjienës personale, kozmetikës, detergjenteve dhe artikujve të tjerë industrialë. Shoqëria gjithashtu kryen aktivitete të tjera ndihmëse në fushën e distribucionit dhe transportit të mallrave.
- Ortaku IJ dhe Ortaku PK kanë rënë dakord të shkëmbejnë ndërmjet tyre kuotat që zotërojnë në shoqëritë e sipërpërmendura sipas kushteve dhe afateve të kësaj Marrëveshjeje, përcaktuar më poshtë.

NENI 1

PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

1.1 Përkufizimet

Përveç termave të përkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje (përfshirë parathëniet dhe anekset e saj), përveç kur konteksti kërkon ndryshe ose përveç kur specifikohet ndryshe këtu më poshtë, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme

- **Marrëveshja** do të thotë kjo Marrëveshje për shkëmbimin/kalimin e kuotave, përfshirë anekset e bashkëngjitura këtu.
- **Aneks(et)** do të thotë aneksi(et) e kësaj Marrëveshjeje, të cilat janë pjesë integrale e saj.
- **Autorizimet** do të thotë të gjitha autorizimet dhe miratimet e nevojshme për ekzekutimin e këtij transaksioni.
- **Dita e Punës** do të thotë çdo ditë kalendarike përveç të shtunave dhe të dielave, dhe çdo ditë tjetër kur bankat nuk janë të hapura për veprimtari të zakonshme në Shqipëri.
- **Data e Nënshkrimit** do të thotë data kur kjo Marrëveshje nënshkruhet nga Palët ose përfaqësuesit e tyre.
- **Data e Hyrjes në Fuqi** do të thotë data 1 Janar 2025.
- **Data e Mbylljes** do të thotë data kur ndodh regjistrimi i ndryshimeve në strukturën e kapitalit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si rezultat i depozitimit të kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve shoqëruese si dhe marrjes së miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës.
- **Informacion Konfidencial** do të thotë çdo informacion në lidhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje, si dhe çdo informacion jo-publik i marrë në lidhje me negociatat e kësaj Marrëveshjeje. Informacion Konfidencial nuk përfshin asnjë informacion që ka qenë ose është bërë i qasur për publikun, përveç nëse ky informacion është bërë publik për shkak të shkeljes së një detyrimi nga ndonjëra Palë sipas kësaj Marrëveshjeje.
- **Forca Madhore** do të thotë çdo urdhër, rregullore, ose udhëzim qeveritar, qoftë i shpallur në formë ligji ose ndryshe, ose çdo sanksion ndërkombëtar ose kombëtar, kryengritje, trazirë, shqetësim civil, luftë (qoftë e shpallur ose jo), veprime ose kërcënime nga grupe ose individë terroristë, zjarre, përmbytje, tërmete, pandemi, epidemi, greva, bllokime, ose çdo shkak tjetër që nuk është për shkak të fajit ose pakujdesisë së Palëve, pavarësisht nëse është i ngjashëm me të mësipërmet, me kusht që çdo shkak i tillë të jetë përtej kontrollit të arsyeshëm të Palës së prekur.
- **Autoriteti Qeveritar** do të thotë çdo gjykatë apo organ qeveritar.
- **Kuotat** do të thotë pjesë të zakonshme të kapitalit, rregullisht të shlyera dhe të nënshkuara, që do të shkëmben sipas kësaj Marrëveshjeje.
- **Kuota IB** do të thotë kuota e zakonshme e barabartë me 52% (pesëdhjetë e dy për qind) të kapitalit në shoqërinë Interbrands Shpk., me vlerë nominale ALL 520,000 (pesëqind e njëzetë mijë) e zotëruar nga Ortaku IJ.

- **Kuota IT&D** do të thotë kuota e zakonshme e barabartë me 24% (njëzetë e katër përqind) të kapitalit në shoqërinë Inter Trade & Distribution Shpk., me vlerë nominale ALL 240,000 (dyqind e dyzetë mijë), zotëruar nga Ortaku PK.
- **Kuota e re IB** do të thotë kuota e zakonshme që, pas shkëmbimit, do të jetë e barabartë me 76% (shtatëdhjetë e gjashtë përqind) të kapitalit në shoqërinë Interbrands Shpk.
- **Kuota e re IT&D** do të thotë kuota e zakonshme që, pas shkëmbimit, do të jetë e barabartë me 76% (shtatëdhjetë e gjashtë përqind) të kapitalit në shoqërinë Inter Trade & Distribution Shpk.
- **IB** do të thotë shoqëria tregtare **Interbrands Shpk.**, e cila aktualisht zotërohet nga 3 (tre) ortakë me përqindjet si vijon:
 1. Plarent Kristo Kapitali ALL 240.000; Numri i kuotave 1; Pjesëmarrja në përqindje 24%.
 2. Roland Joti Kapitali ALL 240.000; Numri i kuotave 1; Pjesëmarrja në përqindje 24%.
 3. Investment Joti - Infosoft Group Shpk.; Kapitali ALL 520.000; Numri i kuotave 1; Pjesëmarrja në përqindje 52%.
- **IT&D** do të thotë shoqëria tregtare **Inter Trade & Distribution Shpk.**, e cila aktualisht zotërohet nga 3 (tre) ortakë me përqindjet si vijon:
 1. Plarent Kristo Kapitali ALL 240.000; Numri i kuotave 1; Pjesëmarrja në përqindje 24%.
 2. Roland Joti Kapitali ALL 240.000; Numri i kuotave 1; Pjesëmarrja në përqindje 24%.
 3. Investment Joti - Infosoft Group Shpk.; Kapitali ALL 520.000; Numri i kuotave 1; Pjesëmarrja në përqindje 52%.

1.2 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje (përfshirë parathëniet dhe Aneksat e saj), përveç kur konteksti kërkon ndryshe ose përveç kur specifikohet ndryshe më poshtë:

- Gjinia mashkullore do të përfshijë gjininë femërore dhe asnjënjë, dhe numri njëjës do të përfshijë numrin shumës dhe anasjelltas.
- Referencat në Marrëveshje për nenet dhe anekset i referohen neneve dhe anekseve të kësaj Marrëveshjeje (përveç kur konteksti kërkon ndryshe).
- Titujt janë vendosur vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.
- Përveç kur shprehimisht tregohet ndryshe, çdo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje që përmend më shumë se një person, do të lidhë secilin prej tyre bashkërisht dhe veç e veç, përveç kur konteksti kërkon ndryshe.
- Një referencë për çdo ligj, rregullorë, statut apo dispozitë tjetër ligjore do të interpretohet si një referencë për të njëjtin ligj siç mund të jetë ndryshuar, modifikuar ose rishpallur herë pas here.
- Një referencë për çdo marrëveshje do të përfshijë çdo ndryshim, modifikim dhe plotësim të saj, dhe çdo heqje dorë prej saj që mund të hyjë në fuqi herë pas here, përveç kur tregohet ndryshe.

- Referencat për çdo dokument në "formë të dakordësuar" i referohen një dokumenti në formën dhe përmbajtjen e dakordësuar nga Palët dhe të nënshkruar nga ose në emër të të gjitha Palëve.
- Kur llogaritet periudha kohore brenda së cilës ose pas së cilës ndonjë veprim duhet të kryhet ose një hap duhet të merret, data që është dita referuese në llogaritjen e kësaj periudhe do të përjashtohet, dhe nëse dita e fundit e kësaj periudhe nuk është Ditë Pune, periudha do të përfundojë në ditën e ardhshme që është Ditë Pune.
- Çdo shtojcë e kësaj Marrëveshjeje, përfshirë Aneksat, përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje dhe do të ketë të njëjtën forcë dhe efekt sikur të ishte shprehur në tekstin kryesor të kësaj Marrëveshjeje, dhe çdo referencë për këtë Marrëveshje do të përfshijë Aneksat dhe çdo shtojcë tjetër të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 2

OBJEKTI I MARRËVESHJES

- 2.1** Objekti i kësaj Marrëveshjeje është shkëmbimi/kalimi i kuotave midis ortakëve IJ dhe PK, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, duke garantuar vijueshmërinë dhe funksionimin normal të shoqërive.
- 2.2** Marrëveshja ka për qëllim rregullimin e të drejtave dhe përgjegjësi të ortakëve lidhur me shkëmbimin/kalimin e kuotave, në përputhje me përqindjen e re të kapitalit të zotëruar nga secili prej tyre në secilën prej shoqërive përkatësisht IB dhe IT&D.

NENI 3

SHKËMBIMI/KALIMI I KUOTAVE

3.1 Objekti i Shkëmbimit/Kalimit

- 3.1.1** Ortaku IJ pranon të transferojë në favor të Ortakut PK një kuotë, që përfaqëson 52% të kapitalit të IB dhe Ortaku PK pranon transferimin e kësaj kuote nga Ortaku IJ. Ky transferim do të përfshijë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga zotërimi i kësaj kuote, duke përfshirë pjesëmarrjen në fitime, të drejtat e votës, si dhe çdo përfitim tjetër financiar apo administrativ të lidhur me kuotat e zotëruara, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
- 3.1.2** Ortaku PK pranon të transferojë në favor të Ortakut IJ një kuotë, që përfaqëson 24% të kapitalit të IT&D dhe Ortaku IJ pranon transferimin e kësaj kuote nga Ortaku PK. Ky transferim do të përfshijë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga zotërimi i kësaj kuote, duke përfshirë pjesëmarrjen në fitime, të drejtat e votës, si dhe çdo përfitim tjetër financiar apo administrativ të lidhur me kuotat e zotëruara, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3.2 Shkëmbimi/Kalimi pa Pagesë

Ortakët kanë rënë dakord që shkëmbimi/kalimi i kuotave objekt i kësaj Marrëveshjeje, do të kryhet pa pagesë shtesë midis tyre, duke marrë parasysh faktin se Kuota IB dhe Kuota IT&D, të përfshira në këtë shkëmbim kanë vlera të krahasueshme, bazuar në të ardhurat që gjenerohen nga aktivitetet tregtare të secilës shoqëri.

3.3 Te Drejtat mbi Fitimet para Shkëmbimit/Kalimit

Palët bien dakord që deri në datën 31 Dhjetor 2024 (përfshirë) do të ushtrojnë të gjitha të drejtat që lidhen me dhe që burojnë nga pronësia mbi Kuotat në shoqëritë IT&D dhe IB si dhe do të marrin

përfitimet përkatëse në formë dividendi që lidhen me pronësinë e kuotës përkatëse para shkëmbimit/kalimit, pavarësisht momentit të pagesës së këtij fitimi si dividend tek ortakët.

3.4 Shkëmbimi dhe kalimi i titullit të pronësisë mbi kuotat e shkëmbyera

- 3.4.1** Palët bien dakord që shkëmbimi dhe kalimi i njëkohshëm i titullit të pronësisë mbi Kuotat ndërmjet ortakëve, palë të kësaj Marrëveshjeje, do të hyjë në fuqi në datën 01 Janar 2025.
- 3.4.2** Në vijim të shkëmbimit dhe kalimit të titullit të pronësisë siç parashikohet në pikën 3.4.1 më lart, Ortaku IJ do të bëhet pronar i një kuote totale, që përfaqëson 76% (shtatëdhjetë e gjashtë përqind) të kapitalit të IT&D (Kuota e re IT&D), dhe do të ketë të drejtë të ushtrisë të gjitha të drejtat që lidhen me dhe që burojnë nga pronësia mbi Kuotën e re IT&D. Ortaku PK nuk do të ketë më të drejta pronësie, të ardhura nga dividendët, të drejta votimi dhe/ose asnjë të drejtë mbi kuotën e shkëmbyer në shoqërinë IT&D duke filluar nga data 1 Janar 2025.
- 3.4.3** Në vijim të shkëmbimit dhe kalimit të titullit të pronësisë siç parashikohet në pikën 3.4.1 më lart, Ortaku PK do të bëhet pronar i një kuote totale, që përfaqëson 76% (shtatëdhjetë e gjashtë përqind) të kapitalit të IB (Kuota e re IB), dhe do të ketë të drejtë të ushtrisë të gjitha të drejtat që lidhen me dhe që burojnë nga pronësia mbi Kuotën e re IB. Ortaku IJ nuk do të ketë më të drejta pronësie, të ardhura nga dividendët, të drejta votimi dhe/ose asnjë të drejtë mbi kuotën e shkëmbyer në shoqërinë IB duke filluar nga data 1 Janar 2025.
- 3.4.4** Struktura e kapitalit në Shoqëritë IB dhe ITD pas shkëmbimit:

Interbrands Shpk. zotërohet nga 2 (dy) ortakë me përqindjet si vijon:

1. Roland Joti (**Pa ndryshime**) Kapital ALL 240.000; Numri i kuotave 1; Pjesëmarrja në përqindje 24%;
2. Plarent Kristo Kapital ALL 760.000; Numri i kuotave 1; Pjesëmarrja në përqindje 76%.

Inter Trade & Distribution Shpk. zotërohet nga 2 (dy) ortakë me përqindjet si vijon:

1. Roland Joti (**Pa ndryshime**) Kapital ALL 240.000; Numri i kuotave 1; Pjesëmarrja në përqindje 24%;
2. Investment Joti - Infosoft Group Shpk.; Kapital ALL 760.000; Numri i kuotave 1; Pjesëmarrja në përqindje 76%.

NENI 4

AFATET E MARRËVESHJES

4.1 Data e Nënshkrimit

Data e Nënshkrimit është data nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga të dy Palët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

4.2 Data e Hyrjes në Fuqi

Kjo Marrëveshje do të fillojë të krijojë efekte nga data 01 Janar 2025. Palët bien dakord që do të ushtrinë të gjitha të drejtat që lidhen me dhe që burojnë nga pronësia mbi Kuotat e shkëmbyera si dhe do të marrin përfitimet përkatëse në formë dividendi duke filluar nga data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

4.3 Data e Mbylljes

Data e Mbylljes do të përkojë me plotësimin e veprimeve si vijon: (i) regjistrimi i ndryshimeve në strukturën e kapitalit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si rezultat i depozitimit të kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve shoqëruese, dhe (ii) marrjes së miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës për ndryshimin e kontrollit në Shoqërinë IB.

NENI 5

KUSHTET PARAPRAKE

5.1 Detyrimet e Ortakut IJ

Në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje por gjithmonë jo më vonë se data 1 Janar 2025, Ortaku IJ duhet të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm për të përfunduar shkëmbimin/kalimin e Kuotës, përfshirë këtu vendimin e asamblesë së ortakëve të IJ që miraton shkëmbimin e kuotës me ortakun PK sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

5.2 Detyrimet e Ortakut PK

5.2.1 Ortaku PK do të depozitojë ose do të ndërmarrë çdo veprim të mundshëm në mënyrë që shoqëria IB të depozitojë brenda afateve ligjore draft marrëveshjen përfundimtare për shkëmbimin/kalimin e Kuotës pranë Autoritetit të Konkurrencës përfshirë çdo informacion apo dokument të nevojshëm për këtë qëllim si dhe analizën përkatëse të ndikimit të këtij shkëmbimi në treg duke marrë dhe miratimin e nevojshëm për përmbylljen e këtij transaksioni.

5.2.2 Për të arritur qëllimin e treguar në pikën 5.2.1 me lart, Ortaku IJ do të bashkëpunojë me Ortakun PK dhe do të mundësojë çdo informacion apo dokument të nevojshëm të lidhur me shoqërinë IB për të arritur qëllimin e sipërpërmendur.

5.3 Detyrime të përbashkëta

Në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, secila nga Palët do të paraqesë dhe/ose do të nënshkruajë çdo vendim të organeve vendimmarrëse, akt përfaqësimi, përfshirë çdo dokument tjetër të nevojshëm të shoqërisë përkatëse në transaksionin e parashikuar në këtë Marrëveshje. Këto dokumente i bashkëlidhen kësaj Marrëveshjeje si Aneksi 1 -Autorizimet.

NENI 6

KUSHTET E ZGJIDHJES

6.1 Mosmiratimi i transaksionit nga Autoriteti i Konkurrencës

Nëse Autoriteti i Konkurrencës refuzon miratimin e këtij shkëmbimi/kalimi, ose nëse nuk merret miratimi i kërkuar brenda datës **01 Prill 2025** apo çdo datë tjetër të rënë dakord nga Palët me shkrim, Palët bien dakord që të kthejnë marrëdhënien e tyre në gjendjen e mëparshme. Kuotat në shoqërinë IB dhe shoqërinë IT&D do të rikthehen në përkatësinë e mëparshme të secilit ortak, dhe asnjëra palë nuk do të ketë të drejta apo pretendime të mëtejshme.

6.2 Angazhimi i Palëve për mosbashkëpunimin me furnitorët e njeri-tjetrit

Secila Palë bie dakord që, për një periudhë 4 vjeçare, nuk do të pranojë të angazhohet dhe bashkëpunojë me furnitorët aktualë të palës tjetër, për distribucionin në Shqipëri të produkteve që distribuohen nga kompanitë IB dhe IT&D. Ky angazhim mund të anulohet vetëm me dakordësinë me shkrim të të dyja Palëve.

Nëse ky angazhim nuk respektohet, Palët bien dakord që të kthejnë marrëdhënien e tyre në gjendjen e mëparshme. Kuotat në shoqërinë IB dhe shoqërinë IT&D do të rikthehen në përkatësinë e mëparshme të secilit ortak, dhe asnjëra palë nuk do të ketë të drejta apo pretendime të mëtejshme.

NENI 7

DREJTIMI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRIVE DHE VENDIMMARRJA

- 7.1 Palët e kësaj Marrëveshjeje bien dakord dhe pranojnë se që nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje deri më datën 01 Janar 2025 apo çdo datë tjetër të rënë dakord me shkrim nga Palët, shoqëria IB dhe shoqëria IT&D do të vazhdojnë veprimtarinë e tyre në rrjedhën normale dhe të zakonshme dhe nuk do të ndërmarrin asnjë veprim jashtë këtij kursi normal dhe të zakonshëm të veprimtarisë, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.
- 7.2 Për të arritur qëllimin e treguar në pikën 7.1, Palët bien dakord që të bashkëpunojnë në mënyrë aktive duke dakordësuar dhe koordinuar vendimmarrjen e ortakëve çdo veprim apo akt të nevojshëm që do të parandalojë ndikime në veprimtarinë e shoqërive objekt i këtij transaksioni të ndërmarrin veprime jashtë kursit normal të veprimtarisë.

NENI 8

PRETENDIMET E PALËVE TË TRETA

- 8.1 Secila nga palët e kësaj Marrëveshjeje, angazhohet të mbajë të pacënuar dhe do të zhdëmtojë Palën tjetër (ose shoqërinë përkatëse) ndaj çdo përgjegjësie që rrjedh nga pretendime të palëve të treta lidhur me zotërimin e Kuotave në shoqëritë përkatëse përpara datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 9

DEKLARATAT DHE GARANCITË

9.1 Deklaratat dhe Garancitë e Ortakut IJ

IJ bën deklaratat dhe jep garancitë e mëposhtme për PK në lidhje me veten e tij, ku secila prej tyre është e vërtetë dhe e saktë në Datën e Nënshkrimit dhe do të jetë e vërtetë dhe e saktë në Datën e Mbylljes.

9.1.1 Organizimi

IJ është një shoqëri tregtare ekzistuese, e themeluar dhe e organizuar rregullisht në bazë të ligjeve të juridiksionit ku ndodhet selia e tij e regjistruar. Shoqëria nuk është në gjendje paaftësie paguese dhe ka të drejta të plota për të kryer aktivitetin e saj tregtar ashtu siç organizohet aktualisht.

9.1.2 Autorizimet

Të gjitha aktet e shoqërisë dhe/ose veprimet e tjera që kërkohen të merren nga ose në emër të IJ për të autorizuar atë për të lidhur dhe për të zbatuar këtë Marrëveshje dhe Dokumentet e Transaksionit ku është palë, janë marrë dhe janë të vlefshme. Kjo Marrëveshje është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga IJ dhe përbën një detyrim të vlefshëm të IJ në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në të.

9.2 Deklaratat dhe Garancitë e PK

PK bën deklaratat dhe jep garancitë e mëposhtme për IJ në lidhje me veten e tij, ku secila prej tyre është e vërtetë dhe e saktë në Datën e Nënshkrimit dhe do të jetë e vërtetë dhe e saktë në Datën e Mbylljes.

9.2.1 Kompetenca për të lidhur këtë Marrëveshje

PK ka tagrat dhe autoritetin e plotë për të nënshkruar dhe zbatuar Marrëveshjen dhe Dokumentet e Transaksionit në të cilat është palë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje. Për nënshkrimin, dorëzimin dhe përfundimin e Marrëveshjes ose kryerjen e detyrimeve të tij në vijim, PK angazhohet të marrë miratimet e parashikuara në këtë Marrëveshje.

9.3 Deklarimet dhe Garancitë e përbashkëta

9.3.1 Pronësia

- i. Secila Palë në këtë Marrëveshje është i vetmi pronar dhe përfitues i të drejtave mbi Kuotën që do të shkëmbejë.
- ii. Kuota në IB dhe IT&D është një kuotë e zakonshme, e nënshkruar dhe e shlyer plotësisht.
- iii. Kuotat në IT&D dhe IB janë të lira nga çdo barrë, dhe Ortaku që zotëron secilën ka të drejtën, kompetencën dhe autoritetin e plotë për të shkëmbyer kuotën përkatëse në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.
- iv. Nuk ekziston asnjë marrëveshje, angazhim apo detyrim për të krijuar apo vendosur një barrë në lidhje me kuotat në IT&D dhe IB.

NENI 10

ZGJIDHJA

10.1 Përveç kur në këtë Marrëveshje parashikohet ndryshe, marrëdhënia midis IJ dhe PK mund të zgjidhet vetëm në rastet e mëposhtme:

- a. Nëpërmjet marrëveshjes me shkrim midis Palëve;
- b. Nëse vërtetohet qoftë edhe një nga Kushtet e Zgjidhjes.

10.2 Në rast verifikimi të një prej kushteve të zgjidhjes sipas pikës 6.1 ose 6.2 më sipër, ose në rast zgjidhjeje me marrëveshje, Palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe të ndërmarrin çdo veprim të nevojshëm në mënyrë që rikthimi në gjendjen fillestare, përpara transaksionit të parashikuar në këtë Marrëveshje, të kryhet sa më shpejt të jetë e mundur.

10.3 Rikthimi në gjendjen e mëparshme nënkupton rikthimin e kuotave për secilin ortak si më poshtë:

Interbrands Shpk. zotërohet nga 3 (tre) ortakë me përqindjet si vijon:

- | | | |
|----|--|---|
| 1. | Roland Joti (Pa ndryshime)
Pjesëmarrja në përqindje 24%; | Kapital ALL 240.000; Numri i kuotave 1; |
| 2. | Plarent Kristo
Pjesëmarrja në përqindje 24%; | Kapital ALL 240.000; Numri i kuotave 1; |
| 3. | Investment Joti - Infosoft Group Shpk.;
Pjesëmarrja në përqindje 52%. | Kapital ALL 520.000; Numri i kuotave 1; |

Inter Trade & Distribution Shpk. zotërohet nga 3 (tre) ortakë me përqindjet si vijon:

- | | | |
|----|--|---|
| 1. | Roland Joti (Pa ndryshime)
Pjesëmarrja në përqindje 24%; | Kapital ALL 240.000; Numri i kuotave 1; |
| 2. | Plarent Kristo
Pjesëmarrja në përqindje 24%; | Kapital ALL 240.000; Numri i kuotave 1; |
| 3. | Investment Joti - Infosoft Group Shpk.;
Pjesëmarrja në përqindje 52%. | Kapital ALL 520.000; Numri i kuotave 1; |

NENI 11

LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJET E MOSMARRËVESHJEVE

11.1 Ligji i Zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

11.2 Juridiksioni

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen në mënyrë përfundimtare nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 12

NJOFTIME

Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera që kërkohen ose mund të jepen në bazë të kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë dhënë në mënyrë të rregullt nëse dërgohen me postë elektronike, dorëzohen me dorë, ose dërgohen me postë të klasës së parë apo përmes një shërbimi të korrierit. Njoftimet duhet të adresohen si më poshtë, ose në çdo adresë tjetër që do të përcaktohet me njoftim të dhënë në mënyrë të rregullt:

Për ortakun Investment Joti - Infosoft Group Shpk.:

Në vëmendje të: Blerta Elezaj;
Adresa: Rruga "Murat Toptani", Gjergji Center, Tiranë;
Email: belezaj@infosoftgroup.com.al.

Për ortakun Plarent Kristo:

Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, Km. 1, Tiranë;
Email: pkristo@ibd.com.al.

Ose në çdo adresë tjetër të përcaktuar nga Pala në njoftimin me shkrim Palës tjetër.

NENI 13

TË NDRYSHME

13.1 Garanci të mëtejshme

Palët bien dakord që të ndërmarrin veprime që nuk janë të parashikuara shprehimisht në këtë dokument, por që janë të nevojshme ose të dëshirueshme për përfundimin e shkëmbimit të Kuotave sipas afateve dhe kushteve të parashikuara këtu.

13.2 Forca Madhore

- 13.2.1** Asnjë Palë nuk do të mbajë përgjegjësi për mosplotësimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje për shkak të Forcës Madhore.
- 13.2.2** Në rast të Forcës Madhore, Pala që është penguar ose vonuar në përmbushjen e detyrimeve duhet të njoftojë Palën tjetër pa hezitim, duke komunikuar të gjitha detajet e plota të Forcës Madhore dhe arsyet e mosplotësimin ose vonësës së saj.
- 13.2.3** Pala duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të zbutur efektet e ngjarjes në mënyrë që të zbatojë Marrëveshjen dhe detyrimet sipas saj.
- 13.2.4** Pas përfundimit të ngjarjes së Forcës Madhore, Pala e prekur duhet sa më shpejt që të jetë e arsyeshme të fillojë përmbushjen e detyrimeve sipas Marrëveshjes.
- 13.2.5** Nëse efektet e Forcës Madhore vazhdojnë për një periudhë prej 60 ditësh ose më shumë, secila nga Palët ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e Marrëveshjes me efekt të menjëhershëm, duke njoftuar me shkrim.

13.3 Marrëveshja e Plotë / Ndryshimet

Kjo Marrëveshje përbën të gjithë Marrëveshjen dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë ose me shkrim, midis Palëve në lidhje me objektin e saj dhe mund të ndryshohet vetëm me akt të nënshkruar nga secila Palë.

13.4 Cedimi

Asnjëra nga Palët nuk do të ketë të drejtë të cedojë ose transferojë të drejtat, përfitimet ose detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje pa një pëlqim paraprak me shkrim të Palës tjetër.

13.5 Efekti Detyrues

Kjo Marrëveshje do të jetë detyruese për Palët dhe pasardhësit e tyre përkatës dhe Palët ku transferimi i të drejtave është lejuar.

13.6 Ndashmëria

Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e paligjshme ose e pazbatueshme, ajo duhet të modifikohet në minimumin e nevojshëm për ta bërë atë të vlefshme, të ligjshme dhe të zbatueshme. Nëse modifikimi nuk është i mundur, dispozita do të hiqet nga kjo Marrëveshje dhe dispozitat e tjera do të mbeten në fuqi.

13.7 Mjete Ligjore të Tjera

Mosushtrimi ose vonesa në ushtrimin e një të drejte ose mjete ligjor të ofruar nga kjo Marrëveshje ose nga ligji nuk përbën heqje dorë nga të drejtat e tjera ose mjete të tjera ligjore. Ushtrimi i pjesshëm i një të drejte nuk përjashton ushtrimin e mëtejshëm të kësaj të drejte apo të një të drejte tjetër.

13.8 Heqja Dorë

Në rast se njëra nga Palët nuk ushtron ose ka vonesë në ushtrimin e një të drejte ose mjete ligjor në lidhje me këtë Marrëveshje, nuk do të konsiderohet si heqje dorë. Heqja dorë nga një shkelje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga shkeljet e mëvonshme.

13.9 Kostot dhe Taksat

Përveç kur Marrëveshja parashikon ndryshe, secila nga Palët duhet të paguajë kostot lidhur me negocimin dhe përgatitjen e kësaj Marrëveshjeje.





13.10 Konfidencialiteti

Në përputhje me këtë Marrëveshje, asnjëra nga Palët nuk duhet të bëjë të njohur Informacione Konfidenciale palëve të treta pa një miratim paraprak me shkrim nga Pala tjetër. Ky detyrim për konfidencialitet nuk zbatohet në rastet kur ligji e kërkon që informacioni të bëhet publik ose me urdhër të një gjykate.

13.11 Gjuha dhe Ekzemplarët

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe dhe çdo përkthim i saj është për lehtësi dhe nuk do të përdoret për interpretimin e Marrëveshjes. Marrëveshja është nënshkruar në disa ekzemplarë që së bashku përbëjnë një dokument të vetëm detyrues.

PALËT

<p>Investment Joti - Infosoft Group Shpk.</p> <p>Përfaqësuar nga:</p> <p>Blerta Elezaj</p> <p></p> <p></p> <p>Tiranë më 05.12.2024</p>	<p>Plarent Kristo</p> <p></p> <p></p> <p>Tiranë më 05.12.2024</p>
--	---

Aneksi 1
Autorizimet
(bashkëlidhur)

**SHOQERIA TREGTARE
INVESTMENT JOTI – INFOSOFT GROUP SHPK
TIRANE
NUIS K91425022E**

**VENDIM
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE
INVESTMENT JOTI – INFOSOFT GROUP SHPK**

Nr. 12 Date 05.12.2024

Sot, me date 05.12.2024, Ortaket e shoqerise Investment Joti – Infosoft Group shpk, shoqeri e formuar sipas ligjit shqiptar dhe e regjistruar me date 25.02.2009 prane Qendres Kombetare te Biznesit, Tirane, me NUIS K91425022E, te njoftuar konform statutit, u mbledhen ne seline e shoqerise ne godinen Gjergji Center, Rr. "Murat Toptani", Tirane, konkretisht:

- 1. Z. Grigor Joti**, i cili zoteron 80% te kapitalit te shoqerise.
- 2. Znj. Marjeta Joti**, e cila zoteron 20% te kapitalit te shoqerise.

Meqenese plotesohet kuorumi i nevojshem, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve ka kompetencen per te marre vendime te vlefshme lidhur me ceshtjet e rendit te dites, konkretisht:

- Miratimi i marreveshjes per shkembimin e kuotave ndermjet shoqerise Investment Joti – Infosoft Group shpk dhe z.Plarent Kristo, me objekt shkembimin e kuotave te zoteruara nga secili ortak ne kapitalin e shoqerise Interbrands shpk dhe shoqerise Inter Trade & Distribution shpk.
- Autorizimi i Administratores se Pergjithshme te shoqerise per nenshkrimin e marreveshjeve dhe dokumentacionit te nevojshem ne zbatim te pikes 1 te rendit te dites.

Ne perfundim te diskutimeve mbi ceshtjen e rendit te dites dhe pasi nuk kishte me ceshtje te tjera per diskutim, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, ne unanimitet,

VENDOSI:

1. Miratohet transferimi i kuotes se zoteruar nga ortaku Investment Joti – Infosoft Group shpk ne shoqerine Interbrands shpk, ne favor te ortakut z. Plarent Kristo.
 - 1.1 Kuota objekt i transferimit perfaqeson 52% te kapitalit te regjistruar te shoqerise Interbrands shpk, me vlere nominale prej 520,000 Leke.
 - 1.2 Pas ketij transferimi, struktura e kapitalit te shoqerise Interbrands shpk do te jete si me poshte:
 - **Roland Joti** :
 - Kapitali 240,000 Leke;
 - Numri i kuotave: 1 (nje);
 - Pjesemarrja ne perqindje: 24%.
 - **Plarent Kristo** :
 - Kapital 760,000 Leke;
 - Numri i kuotave: 1(nje);
 - Pjesemarrja ne perqindje: 76%.
 - 1.3 Transferimi do te perfshije te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kesaj kuote, duke perfshire te drejten per pjesemarrje ne fitime, te drejtat e votes, si dhe çdo perfitim tjeter financiar apo administrativ qe lidhet me zoterimin e kesaj kuote, duke filluar nga data e hyrjes ne fuqi te marreveshjes per shkembimin e kuotave.

- 1.4 Ne daten e hyrjes ne fuqi te marreveshjes per shkembimin e kuotave, shoqeria Investment Joti – Infosoft Group shpk, humb cilesine e ortakut ne shoqerine Interbrands shpk.
2. Miratohet transferimi i kuotes se zoteruar nga z. Plarent Kristo ne kapitalin e shoqerise Inter Trade & Distribution shpk, ne favor te ortakut Investment Joti – Infosoft Group shpk.
- 2.1 Kuota objekt i transferimit perfaqeson 24% te kapitalit te regjistruar te shoqerise Inter Trade & Distribution shpk, me vlere nominale prej 240,000 Leke.
- 2.2 Pas ketij transferimi, struktura e kapitalit te shoqerise Inter Trade & Distribution shpk do te jete si me poshte:
1. **Roland Joti:**
 - Kapitali 240,000 Leke;
 - Numri i kuotave: 1 (nje);
 - Pjesemarrja ne perqindje: 24%.
 2. **Investment Joti – Infosoft Group:**
 - Kapitali 760,000 Leke;
 - Numri i kuotave: 1 (nje);
 - Pjesemarrja ne perqindje: 76%.
- 2.3 Transferimi do te perfshije te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kesaj kuote, duke perfshire te drejten per pjesemarrje ne fitime, te drejtat e votes, si dhe çdo perfitim tjetër financiar apo administrativ qe lidhet me zoterimin e kesaj kuote, duke filluar nga data e hyrjes ne fuqi te marreveshjes per shkembimin e kuotave.
- 2.4 Ne daten e hyrjes ne fuqi te marreveshjes per shkembimin e kuotave, Z.Plarent Kristo, humb cilesine e ortakut ne shoqerine Inter Trade & Distribution shpk.
3. Miratimin e marreveshjes per shkembimin/kalimin e kuotave ndermjet shoqerise Investment Joti – Infosoft Group Shpk. dhe z. Plarent Kristo, per kuotat e zoteruara nga secili ortak ne kapitalin e shoqerise Interbrands Shpk. dhe shoqerise Inter Trade & Distribution Shpk., sipas kushteve te percaktuara ne draft-in e dakordesuar qe do te nenshkruhet nga palet, me fuqi nga data 01.01.2025.
4. Autorizohet Administratorja Pergjithshme e shoqerise Investment Joti – Infosoft Group shpk, znj. Blerta Elezaj, per nenskrimin e marreveshjeve dhe dokumentacionit te nevojshem ne zbatim te ketij vendimi.

Duke konstatuar perfundimin e shqyrtimit te te gjitha çeshtjeve te rendit te dites dhe mungesen e çeshtjeve te tjera per diskutim, mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve u deklarua e mbyllur.

ORTAKET

Grigor JOTI



Marjeta JOTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

Nr. 816/12 prot.

Tiranë, më 19.12.2024

Lënda: Vlerësim mbi transaksionin e njoftuar.

Lalaj & Partners SHPK

Rruga e Kavajës, Kompleksi Square 21, Shkalla 1, Kati 9, Apt.36,

Tiranë

I / E nderuar,

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa 816 prot. i AK, datë 12.12.2024 “Dërgim i Formularit të Thjeshtuar të Njoftimit dhe Dokumenteve Mbështetëse”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e shkëmbimit / kalimit të kuotave ndërmjet shoqërisë Investment Joti – Infosoft Group SHPK dhe Z. Plarent Kristo.

Referuar Marrëveshjes për shkëmbimin / kalimin e kuotave të datës 05 dhjetor 2024, ortakët Investment Joti – Infosoft Group SHPK dhe Z. Plarent Kristo kanë rënë dakort që të shkëmbejnë ndërmjet tyre kuotat që zotërojnë në shoqëritë INTERBRANDS SHPK, (Investment Joti – Infosoft Group SHPK 1 kuotë që përfaqëson 52% të kapitalit) dhe INTER TRADE & DISTRIBUTION SHPK, (Plarent Kristo 1 kuotë që përfaqëson 24% të kapitalit).

Në përfundim të transaksionit, shoqëria Investment Joti – Infosoft Group SHPK do të bëhet pronare e një kuote totale, që përfaqëson 76% të kapitalit të shoqërisë INTER TRADE & DISTRIBUTION SHPK dhe Z. Plarent Kristo do të bëhet pronar i një kuote totale, që përfaqëson 76% të kapitalit të shoqërisë INTERBRANDS SHPK. Pas përfundimit të transaksionit, numri i ortakëve të shoqërive target do të reduktohen në 2 ortakë, të cilët do të ushtrojnë të gjitha të drejtat që lidhen dhe që burojnë nga pronësia mbi kuotat e reja.

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 80 përcaktohet se: “Reduktimi / zvogëlimi i numrit të aksionarëve kontrollues përbën një ndryshim të cilësisë së kontrollit dhe në këtë mënyrë konsiderohet si një përqendrim, nëse dalja e një ose më shumë aksionarëve kontrollues rezulton në një ndryshim të kontrollit nga kontroll i përbashkët në atë të vetëm. ***Kur operacioni përfshin një reduktim të numrit të aksionarëve kontrollues të përbashkët, pa çuar në një ndryshim të kontrollit nga ai i përbashkët në atë të vetëm, transaksioni normalisht nuk do të çojë në një përqendrim që duhet të njoftohet.***

Nga sa më sipër, transaksioni i njoftuar nuk ka për pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërive INTER TRADE & DISTRIBUTION SHPK dhe INTERBRANDS SHPK, duke qenë se shoqëritë kanë patur kontroll të përbashkët që përpara realizimit të transaksionit dhe do të vazhdojnë ta kenë edhe pas përfundimit të transaksionit, pasi do të zotërohen dhe kontrollohen nga 2 ortakë me kuota të barabarta ndërmjet tyre.

Për këto arsye, ky transaksion nuk do të nënshtrohet procedurave të kontrollit të përqendrimeve të parashikuar në nenet 53-64 të ligjit dhe nuk do të jetë objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës me nr.778, datë 04.03.2021 “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, me ndryshimet e bëra në nenin 4, pika 1. a, të kësaj Rregulloreje, keni detyrimin për të paguar faturën bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Konceptoi: M. Bajko

Konfirmoi: Dh. Skënderi

Miratoi: E. Çekani

KRYETAR

Denar BIBA

